



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 35

Tiranë – E mërkurë, 1 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i institucionit të Presidentit të Republikës nr. 2447/4, datë 31.10.2017	Për shpalljen e vendeve vakante pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA)..... 3



NJOFTIM I INSTITUCIONIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Nr. 2447/4, datë 31.10.2017

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, shpall vendet vakante për pozicionet:

1. Specialist Financë/Buxhet

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijojnë:

a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master shkencor” në Ekonomi, dega Financë.

b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

c) Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.

d) Të ketë njohuri në programet financiare si: *Alpha/Financa 5* etj.

2. Specialist i Burimeve Njerëzore

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijojnë:

a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master shkencor”.

b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

c) Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

3. Specialist IT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijojnë:

a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master shkencor” në Inxhinieri informatike, Informatikë, Teknologji informacioni etj.

b) Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e Teknologjisë së informacionit.

c) Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve, si: *Active Directory, Outlook Mail Client*.

d) Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.

e) Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve *web* (*Wordpress, Drupal, Joomla* etj.).

f) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

4. Specialist Protokoll/Arkive

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master shkencor”.

b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

c) Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t’u pajisur me Certifikatë sigurie, sipas vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 nëntor deri më 10 nëntor 2017, në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e hëna në të premte, ora: 09:00 - 16:00.**

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare, pranë institucionit të KPA-së në adresën: **Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 nëntor deri më 10 nëntor 2017, në adresën: info@kpa.al. KPA-ja konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:



1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

2. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim (ID), librezë pune) origjinal ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal.

4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore.

5. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

6. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

7. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2017